

## RELACION TEKNIK (PROJEKT ME PERSHKRIM)

KONTRATA NR. 9 : “MIRËMBAJTJE RUTINE ME PERFORMANCË RRUGA K/MUZINE – DELVINE + RRUGA URA E GAJDARIT – DELVINE + RRUGA URA E GAJDARIT – QAFE GJASHTE + RRUGA KARDHIQ – DELVINE (LOTI 1) + RRUGA KARDHIQ – DELVINE (LOTI 2+3) + RRUGA E PLAZHIT KAKOME 47.2 KM”

### 1. Qëllimi i Shërbimeve që do kryhen

Shërbimet që do mundësohen përfshijnë gjithë veprimtaritë, fizike dhe të tjera, që duhet të kryhen, sipas përputhshmërisë së tyre me Nivelet e Shërbimit dhe kriterin e caktuar të realizimit të tyre të performancës, apo me çdo kërkesë tjetër.

Në vecanti, ato përfshijnë detyrat menaxheriale dhe punimet fizike që lidhen me asetet dhe zërat që lidhen me rrugën:

- Asfaltimet
- Bankinat
- Sinjalistika dhe furnizimi pajisjet për sigurinë rrugorë
- Strukturat e drenazhimit
- Kontrolli i vegjetacionit
- Skarpatat (gërmimet dhe bankinat)
- Veprat e artit
- Menaxhimi i trafikut
- Grumbullimi i dherave
- Pastrimi i dëborës (nqs ka mirëmbajtje dimërore)

Shërbimet që kërkon Mirëmbajtja e një rruge klasifikohen në:

2. Punimet Rehabilituese/periodike, në formën e sasisë së një vlere tavan, ndërsa tregohen sasisë e punimeve të matëshme që do kryhen në mënyrë që rruga të arrijë Standardet e asaj performancë.
3. Shërbimet e Mirëmbajtjes Rutinë në formën e sasisë së shprehur në një vlerë tavan mujore (kjo do jetë një sasi mujore e aplikueshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës së shprehur në çmim për kilometër për secilin muaj e shumëzuar me gjatësinë e rrugës dhe kohëzgjatjen e shërbimeve);
4. Punimet Emergjente në formën e një preventivi tradicional.

Funksionet kryesore të bazave të mirëmbajtjes në përgjithësi, duhet të jenë si më poshtë:

1. Mbikëqyrja e segmentit/seksionit rrugor në periudha të caktuara sipas niveleve të shërbimit
2. Kontrolli i të dhënave të trafikut për këtë segment
3. Vëzhgimi i faktorëve meteorologjikë
4. Ndihma e parë në rast aksidenti (në lidhje me elementët e rrugës dhe trafikut)
5. Mirëmbajtje në kushtet e dëshiruara të shtresave rrugore
6. Mirëmbajtja e hapësirave të parkimit, shërbimit, shenjave rrugore, sistemeve të ndriçimit, sinjalizimit të ardhshëm e telekomunikacionit.
7. Riparime dhe rindërtim pas aksidenteve rrugorë
8. Riparime dhe rindërtim pas fatkeqësive natyrore
9. Operacionet e pastrimit të drenazheve, tombinove dhe objekteve të tjera që lidhen me largimin e ujrave nga sipërfaqja e rrugës

10. Të gjithë operacionet për pastrimin dhe mirëmbajtjen e :
- shenjave rrugore, pajisjeve të sigurise (gardhe, parapet) sistemi i ndricimit.
  - riparimi lokal i dëmtimeve të trotuarit
  - kujdesi për bimesinë
  - aktiviteti në dimer për largimin e dëborës dhe akullit.

*Punimet e mirëmbajtjes në kushtet dimërore, përfshijnë:*

1. Punime paraprake para fillimit të kushteve të dimrit
2. Organizimi i vendodhjeve të depozitimit të materialeve
3. Masat mbrojtëse për borën, akullin, grumbujt e borës dhe ortekët
4. Pastrimi i dëborës nga karrexhata e autostrades dhe sinjalet e komunikacionit dhe shenjat
5. Shenjimi i anëve të karrexhatës
6. Sigurimi i funksionimit të drenazhimit nga karrexhata
7. Heqjen e automjeteve nga rruga
8. Instalimi i sinjaleve të vecanta të komunikacionit në rastet e rregjimit të trafikut të veçantë të mbylljes së rrugës.
9. Informimi i vazhdueshëm i publikut për gjëndjen e rrugës dhe rrjedhën e trafikut.

## 5. Akset rrugore që mbulon kontrata:

Nr. Rrugës	Nr. Rendor	Emërtimi i Rrugëve	Kategoria e rrugës	Gjatësia totale (km)	Gjerësia (m)
SH 78	1	K/Muzine – Delvine	C	14.7	5
SH 78	2	Ura e Gajdarit – Delvine	C	11.9	6
SH 99	3	Ura e Gajdarit – Qafe Gjashte	C	1.2	10.5
W 57	4	Kardhiq – Delvine (Loti nr. 1)	C	7.2	9.5
W 57	5	Kardhiq – Delvine (Loti nr. 2+3)	C	9.2	9.5
W74	6	Rruga e Plazhit Kakome	F	3	5
<b>SHUMA E KONTRATES:</b>				<b>47.2</b>	

## 6. Kusht i veçantë

Për çdo rast, nga kontrata do të zbriten segmente të saj nqs do të përfshihen në investim (rikonstrukcion) apo projekte të tjera të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

## 7. Sinjalistika dhe siguria rrugore

Mirëmbajtja e sinjalistikës dhe siguria rrugore (barrierat) do të fokusohet tek riparimi dhe rifreskimi e asaj ekzistuese.

## 8. Përshkrimi i zonës ku ndodhen rrugët dhe gjendja teknike.

### I – Aksi rrugor K/Muzine – Delvine 14.7 km

Ky aks rrugor është pjesë e segmentit rrugor që lidh Delvinen me Gjirokastrën dhe me fshatrat që ndodhen në afersi të rrugës. Është një aks i rëndësishëm nga pikpamja social – ekonomike pasi kalon në disa qendra të banuara, i shërben një komuniteti të konsiderueshëm banoresh dhe bizneseve të karakterit bujqësor e blegtoral.

Rruga shtrihet ne nje terren kodrinor – malor me parametra planimetrike te disfavorshme ne te gjithe gjatesine e tij. Rruga zhvillohet me kthesa te vazhdueshme te forta si dhe gjeresia e rruges eshte e vogel. Edhe parametrat altimetrike te rruges jane te disfavorshme ne te gjithe gjatesine e tij. Pjesa me e madhe e aksit shtrihet ne nje terren malor shume te thyer.

Rruga eshte rikonstruktuar para rreth 30 vitesh dhe shtresat asfaltike jane ndertuar me penetracion. Aktualisht shtresat asfaltike jane shume te amortizuara dhe pjeserisht plotesisht te amortizuara. Nisur nga gjendja shume e keqe e shtresave rrugore kjo rruge gjate hartimit te preventivit do te trajtohet si rruge e paasfaltuar. Formacionet gjeologjike ku kalon rruga jane ne pergjithesi formacione te qendrueshem. Edhe skarpatet e rruges kane qendrueshmeri relativisht te mire.

Kanalet anësore kanë nevojë për ndërhyrje e pastrime vazhdimisht. Aksi permban vepra arti e mure mbajtës e pritës, te nevojshëm qe paraqiten te amortizuar dhe kane nevoje per mirembajtje e riparime.


Sinjalistika dhe siguria rrugore jane ne nivele te uleta pasi kjo rruge eshte trajtuar si rruge e paasfaltuar dhe nisur nga nevoja per rikonstuksion nuk eshte investuar ne kete drejtim dhe ne kontratat e meparshme te mirembajtjes nuk eshte perfshire sinjalistika. Rruga ka nevoje per rikonstruksion total.

Nga pikpamja e Mirembajtjes Dimerore rruga nuk paraqet probleme shqetesuese. Reshjet e debores jane te rralla. Formimi i ngricave dhe akullit ne stinen e dimrit eshte evident ne rastet e temperaturave te uleta dhe duhet te menaxhohet.

Rruga është në terren kodrinor – malor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore.

**Koordinatat gjeografike te fillimit: 39°56'01.9", 20°12'12.5"**

**Koordinatat gjeografike te mbarimit : 39°57'16.7", 20°06'08.6"**



## II - Aksi rrugor Ura e Gajdarit – Delvine 11.9 km

Ky aks rrugor lidh Delvinen me Saranden, me Bregdetin e Jugut dhe me fshatrat qe ndodhen ne afersi te rruges. Eshte nje aks i rëndesishem nga pikpamja social – ekonomike pasi kalon ne disa qendra te banuara, i sherben nje komuniteti te madh banoresh dhe shume bizneseve te karakterit bujqesor e blegtoral. Gjithashtu eshte nje rruge e rëndesishme qe te con ne destinacione turistike. Rruga shtrihet ne nje terren kodrinor – fushor me parametra planimetrike te favorshme me perjashtim te pak kthesave te forta. Edhe parametrat altimetrike te rruges jane te favorshme ne te gjithe gjatesine e tij. Pjesa me e madhe e aksit shtrihet ne nje terren fushor. Segmenti i rruges nga km 0 – 5.7 eshte nen rikonstrukcion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe gjate vitit 2025 dhe vitit 2026 ky segment do te jete ne garanci difektesh.

Është nje rruge me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Shtresat asfaltike km 0 – 5.7 janë në gjendje të mirë , pasi aksi eshte rikonstruktuar dhe gjendja aktuale e tij paraqitet pa probleme. Shtresat asfaltike km 5.7 – 11.9 janë në gjendje të amortizuar, ka nevojë per riparime dhe riveshje me asfaltobeton.

Kanalet anësore kanë nevojë për ndërhyrje vazhdimisht me mirembajtje e pastrime. Veprat e artit jane ne gjendje te relativisht te mire por kane nevojë per mirembajtje.


Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për permiresime, zëvendësime të pjesshme dhe rifreskime. Problem perben prezenca e madhe e kembesoreve, pasi rruga kalon ne qendra te banuara me qarkullim te madh kembesoresh, prandaj duhen marre masa per vendosjen e sinjalistikes shtese paralajmeruese.

Nga pikpamja e Mirembajtjes Dimerore rruga nuk paraqet probleme shqetesuese. Reshjet e debores jane te rralla. Formimi i ngricave dhe akullit ne stinen e dimrit eshte evident ne rastet e temperaturave te uleta dhe duhet te menaxhohet.

Rruga është në terren kodrinor – fushor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore.

**Koordinatat gjografike te fillimit:** 39°52'52.6", 20°02'07.7"

**Koordinatat gjografike te mbarimit :** 39°56'59.1", 20°05'38.7"



### III- Aksi rrugor Rrethqarkullimi Ura e Gajdarit – Qafe Gjashte 1.2 km

Aksi rrugor Ura e Gajdarit – Qafe Gjashte eshte nje segment i rendesishem kombetar. Ai eshte pjese e rruges se hyrjes te qytetit te Sarandes. Nga pikpamja social – ekonomike paraqitet me rendesi te vecante, pasi i sherben nje komuniteti te madh banoresh. Eshte nje aks rrugor me trafik shume te madh i cili ne muajt e veres per arsye te turizmit shumefishohet. Nga pikpamja turistike eshte nje aks me rendesi te vecante. Rruga shtrihet ne nje terren kodrinor me parametra planimetrike te disfavorshme pasi zhvillohet me kthesa te forta te njepasnjeshme. Edhe parametrat altimetrike jane te veshtira pasi pjerresia e niveletave te rruges eshte e madhe. Ky segment rrugor eshte rikonstruktuar totalisht nga Autoriteti Rrugor Shqiptar ne vitet 2018-2019.

Është nje rruge me një karrexhatë me dy kahe lëvizje, ne ngjitje eshte me dy korsi kurse ne zbritje eshte me nje korsi. Rruga ka nje gjeresi te kenaqshme.

Shtresat asfaltike janë në gjendje pergjithesisht të mirë , mund te kete nevojje per riparime te vogla.

Kanalet anësore, tombinot dhe veprat e artit jane ne gjendje te mire por kanë nevojë për mirembajtje vazhdimisht.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për permiresime, zëvendësime të pjesshme dhe rifreskime. Problem perben prezenca e madhe e kembesoreve, pasi rruga kalon ne qendra te banuara me qarkullim te madh kembesoresh, prandaj duhen marre masa per vendosjen e sinjalistikes shtese paralajmeruese.


Nga pikpamja e Mirembajtjes Dimerore rruga nuk paraqet probleme te medha. Reshjet e deboret jane shume te rralla. Formimi i ngricave dhe akullit ne stinen e dimrit eshte evident ne rastet e temperaturave te uleta dhe duhet te menaxhohet.

Rruga është në terren fushor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore

Niveli i kërkuar i shërbimit “i mirë”.

**Koordinat gjeografike te fillimit: 39°52'52.6", 20°02'07.7"**

**Koordinat gjeografike te mbarimit : 39°52'30.3", 20°01'37.5"**



#### IV- Aksi rrugor Kardhiq – Delvine (Loti 1) 7.2 km

Ky segment rrugor është pjesë e aksit të ri rrugor Kardhiq – Delvine konkretisht loti i parë që fillon në rrugën SH 4 Gjirokastrë – Tepelene dhe perfundon në afërsi të fshatit Kardhiq. Nga pikpamja sociale – ekonomike paraqitet me rëndësi të vecante, pasi i shërben një komuniteti të madh banorësh. Është një aks rrugor me trafik shumë të konsiderueshëm i cili në muajt e verës për arsye të turizmit shumëfishohet. Nga pikpamja turistike është një aks me rëndësi të vecante. Rruga shtrihet në një terren fushor - kodrinor me parametra planimetrike të favorshme, me një gjeresi të krenaqshme me pak kthesa të buta. Edhe parametrat altimetrike janë të mira. Ky segment rrugor është rikonstruktuar totalisht nga Autoriteti Rrugor Shqiptar në vitet 2010-2012.

Është një rrugë me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Shtresat asfaltike janë në gjendje përgjithësisht të mirë, mund të ketë nevojë për riparime të vogla.

Kanalet anësore, tombinat dhe veprat e artit janë në gjendje të mirë por kanë nevojë për mirëmbajtje vazhdimisht. Problemi më i shprehur është paqëndrueshmëria e skarpave në segmentin km 3 – 6 ku kemi rënieshëm, masive dherash, depozitime të ngurta në rrugë rënieshëm shkuresh dhe pemesh nga skarpata etj. Këto probleme do minimizohen me përfundimin e projektit për stabilizimin e skarpave nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, megjithatë kërkohet vëmendje dhe kujdes në monitorimin e problemeve që vijnë nga paqëndrueshmëria e skarpave si dhe pastim i menjehershëm në rastet e rënieshëm dhe depozitimit të materialeve të ngurta në rrugë.

Sinjalistika dhe siguria rrugore janë në gjendje të mirë, mund të ketë nevojë për përmirësime, zëvendësime të pjesshme dhe rifreskime. Problemi përben prania e madhe e kembësoreve, pasi rruga kalon në qendra të banuara me qarkullim të madh kembësorësh, prandaj duhen marrë masa për vendosjen e sinjalistikës shtesë paralajmëruese.


Nga pikpamja e Mirëmbajtjes Dimërore rruga nuk paraqet probleme të mëdha. Reshjet e deboret janë të rralla. Formimi i ngricave dhe akullit në stinën e dimrit është evident në rastet e temperaturave të ulëta dhe duhet të menaxhohet.

Rruga është në terren fushor – kodrinor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore

Niveli i kërkuar i shërbimit “i mirë”.

**Koordinat gjeografike të fillimit:** 40°08'50.5", 20°05'45.6"

**Koordinat gjeografike të mbarimit :** 40°07'33.2", 20°01'16.3"



## V- Aksi rrugor Kardhiq – Delvine (Loti 2+3) 9.2 km

Ky segment rrugor është pjese e aksit te ri rrugor Kardhiq – Delvine konkretisht loti i dyte dhe i trete qe fillon ne rrethqarkullimin e Shijanit dhe perfundon ne afersi te fshatit Fushe Verri. Nga pikpamja social – ekonomike paraqitet me rendesi te vecante, pasi i sherben nje komuniteti te madh banoresh. Eshte nje aks rrugor me trafik te konsiderueshem i cili ne muajt e veres per arsye te turizmit shumefishohet. Nga pikpamja turistike eshte nje aks me rendesi te vecante. Rruga shtrihet ne nje terren fushor me parametra planimetrike te favorshme, me nje gjeresi te kenaqshme me pak kthesa te buta. Edhe parametrat altimetrike jane shume te mira. Ky segment rrugor eshte rikonstruktuar totalisht nga Autoriteti Rrugor Shqiptar ne vitet 2010-2012.

Është nje rruge me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Shtresat asfaltike janë në gjendje pergjithesisht të mirë, mund te kete nevojë per riparime te vogla.

Kanalet anësore, tombinot dhe veprat e artit jane ne gjendje te mire por kanë nevojë për mirembajtje vazhdimisht.

Sinjalistika dhe siguria rrugore jane ne gjendje te mire, mund te kete nevoja për permiresime, zëvendësime të pjesshme dhe rifreskime. Problem perben prezenca e madhe e kembesoreve, pasi rruga kalon ne qendra te banuara me qarkullim te madh kembesoresh, prandaj duhen marre masa per vendosjen e sinjalistikes shtese paralajmeruese.


Nga pikpamja e Mirembajtjes Dimerore rruga nuk paraqet probleme te medha. Reshjet e debores jane te rralla. Formimi i ngricave dhe akullit ne stinen e dimrit eshte evident ne rastet e temperaturave te uleta dhe duhet te menaxhohet.

Rruga është në terren fushor – kodrinor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore

Niveli i kërkuar i shërbimit “i mirë”.

**Koordinat gjeografike te fillimit:** 39°55'22.7", 20°02'24.6" (Rrethqarkullimi i Shijanit)

**Koordinat gjeografike te mbarimit :** 39°59'51.6", 20°00'27.5" (Fushe Verri)



#### **VI- Rruga e Plazhit Kakome 3 km**

Eshte nje rruge e rëndesishme qe te con ne destinacione turistike, në shërbim të turizmit të vijës bregdetare, e kategorise F që lidh rrugën nacionale SH8 me Plazhin në gjirin e Kakomesë. Eshte nje aks i rëndesishem nga pikpamja social – ekonomike pasi i shërben bizneseve te karakterit turistik qe operojne ne kete zone. Rruga shtrihet ne nje terren kodrinor – fushor me parametra planimetrike te disfavorshme pasi rruga zhvillohet me kthesa dhe gjeresia e saj eshte relativisht e vogel. Parametrat altimetrike te rruges jane ne pergjithesi te favorshme ne te gjithë gjatesine e tij.

Rruga eshte rikonstruktuar nga Autoriteti Rrugor Shqipar para rreth 10 vitesh ne te gjithë gjatesine e saj.

Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje me gjerësi te asfaltuar 5 m.

Shtresat asfaltike janë në gjendje pjesërisht te amortizuar, kane nevojë per riparime me asfaltobeton.



Kanalet anësore e kunetat kanë nevojë për ndërhyrje vazhdimisht me mirembajtje e pastrime. Veprat e artit janë në gjendje relativisht të mira, por kanë nevojë për mirembajtje.

Kemi rritje të gjerësisë dhe shpatet e rrugës në sipërfaqen e asfaltuar, prandaj duhet të mbahet në monitorim i gjithë aksionet rrugor në lidhje me këtë problem.


Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për përmirësime, zëvendësime të pjesshme dhe rifreskime. Problemi përben prezencën e madhe të këmbësorëve sidomos në stinën e verës ku kemi qarkullim të madh këmbësorësh, prandaj duhet marrë masa për vendosjen e sinjalistikës shtesë paralajmëruese.

Nga pikpamja e Mirembajtjes Dimërore rruga nuk paraqet probleme shqetësuese. Reshjet e deboret janë shumë të rralla. Formimi i ngricave dhe akullit në stinën e dimrit është një fenomen që ndeshet rrallë në rastet e temperaturave të ulëta, megjithatë kërkohet gadishmeri dhe çdo rast i tillë duhet të menaxhohet nga Kontraktori.

Rruga është në terren kodrinor – fushor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore.

**Koordinatat gjeografike të fillimit: 39°55'39.6" , 19°58'46.2"**

**Koordinatat gjeografike të mbarimit : 39°55'40.4" , 19°57'06.9"**



## **GRUPI I PUNES**